



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Gjakovës
Opština Djakovica-Municipality of Gjakova

DRAFT RREGULLORE

MBI PLOTËSIMIN E KUSHTEVE MINIMALE HIGJENIKE, TEKNIKE DHE SANITARE PËR LOKALET AFARISTE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË GJAKOVËS

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore si qëllim primar ka përcaktimin e kushteve minimale higjienike, teknike dhe sanitare për lokalet afariste në të cilat ushtrohet veprimtaria ekonomike e caktuar, brenda territorit të Komunës së Gjakovës.

Neni 2

Fushëveprimi

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet minimale të cilat duhet ti plotesojne lokalet afariste, tregjet, kioskat, vetesherbimi/marketi, qendrat tregtare dhe shitja jashtë lokaleve afariste dhe kioshave në të cilat ushtrohet veprimtaria ekonomike e caktuar brenda territorit të Komunës së Gjakovës, detyrat dhe përgjegjësit e pronareve të shoqërive tregtare, personave fizik dhe juridik, personave përgjegjës, pronareve të lokaleve afariste, mbikqyrja inspektuese dhe masat tjera administrative.

Neni 3

Përkufizimet

1. **Komuna:** Komuna e Gjakovës, siç është paraparë me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.
2. **DPI:** Drejtoria për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës.
3. **Veprimtari Ekonomike:** Në kuptim të kësaj rregullore, veprimtari ekonomike do të thotë çdo lloj aktiviteti i rregullt ose i përsëritur i cili përfshin ofrimin, tregtimin, sigurimin ose prodhimin e mallrave/produnkteve, shërbimeve, pronës dhe/ose punëve për një person ose Shoqëri Tregtare, në këmbim ose në pritje të çfarëdo lloj pagese ose kompensimi.
4. **Shoqëri Tregtare:** Siç është paraparë me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
5. **Komisioni për pranim teknik:** Inspektori i Tregut dhe Inspektori Sanitar në Komunën e Gjakovës.
6. **Rregullore:** Rregullorja mbi plotësimin e kushteve minimale higjienike, teknike dhe sanitare për lokalet afariste në territorin e Komunës së Gjakovës.

7. **Lokal afarist:** Për nevoja të kësaj rregullore, lokal afarist konsiderohet çdo pronë e paluajtshme, apo objekt i përkohshëm ku tregtari kryen veprimtarinë e tij ekonomike në bazë të përhershme ose të përkohshme.
8. **Pëlqimi:** Dokumenti zyrtar i cili i lëshohet shoqërisë tregtare nga kryesuesi i komisionit për pranim teknik, pasi që të konstatohet nga komisioni për pranim teknik së lokali afarist i plotëson kushtet minimale higjienike, teknike dhe sanitare.
9. **Hapësire ndihmëse:** Objektet/lokalet në të cilat bëhet ruajtja e produkteve, hapësirat për vendosjen e mbeturinave, produkteve të prishura apo të dëmtuara, hapësirat për nevojat higjienike të punësuarve dhe konsumatorëve, vendi për mjetet/produktet higjienike dhe të ngjashme.
10. **Vetëshërbimi/marketi:** Lokali afarist në të cilën shitja e produkteve organizohet në mënyrë të vetëshërbimit nga konsumatori.
11. **Qendër Tregtare:** Për nevoja të kësaj rregullore si qendra tregtare konsiderohen objektet në të cilat gjinden së paku dy lokale afariste të ndarë fizikisht.
12. **Tregjet:** Sipas kësaj rregullore tregjet konsiderohen vende të hapura apo të mbyllura të cilat janë të organizuara dhe të rregulluara në atë mënyrë ku brenda asaj hapësirë ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike (në stenda, tavolina e ngjashëm) dy e më shumë tregtar, në baza ditore apo dhe në ditë të caktuara të javës.
13. **Kioska:** Sipas kësaj rregullore, kiosk është lokali/objekti që mund të shpëputet nga toka, madhësia e së cilës në brendësi nuk kalon 4 m², në të cilën shiten produkte apo ofrohen shërbime përmes sportelit, pa mundësi hyrje të blerësit në brendësi.
14. **Shitja jashtë lokaleve afariste dhe kioskave:** Për nevoja të kësaj rregullore, me shitje jashtë lokaleve afariste nënkuptohet shitja në stenda, përmes automatëve, përmes karrocave, panairove apo në mjete lëvizëse të parapara për shitje apo ofrimin e shërbimeve të produkteve aty për aty për konsumatorët.

Neni 4

Ushtrimi i veprimtarisë ekonomike

1. Të gjithë pronaret e shoqërive tregtare mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike e cila është e lejuara me ligj.
2. Të gjithë pronaret e shoqërive tregtare ushtrojnë lirisht veprimtarinë e tyre ekonomike në kushte të barabarta pa dallime, diskriminim dhe privilegje, në pajtim me dispozitat ligjore.

Neni 5

Obligimi i shoqërive tregtare

1. Të gjitha shoqëritë tregtare të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në lokalet afariste, tregje, kioska, qendra tregtare dhe markete të cilat gjinden në territorin e Komunës së Gjakovës janë të obliguara të pajisen me pëlqim para se të fillojnë ushtrimin e veprimtarisë ekonomike.

2. Para pajisjes me pëlqim, mund të ushtrojnë veprimtarinë ekonomike vetëm për ato aktivitete që janë të nevojshme për efekt të pajisjes me pëlqim.
3. Çdo pronar i shoqërisë tregtare ka për obligim që pëlqimin ta vendos në vend të dukshëm në brendësi të lokalit dhe ta prezantoj atë kur do që i kërkohet nga inspektori.
4. Të gjitha shoqëritë tregtare janë të obliguara që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre ekonomike të mos bien ndesh me Ligjin për Rendin dhe Qetësinë Publike dhe Ligjin në fuqi për Mbrojtje nga Zhurma, si dhe aktet tjera nën ligjore që rregullojnë këtë fushë.

Neni 6

Kushtet e përgjithshme minimale

1. Të gjitha lokalet afariste duhet të plotësojnë këto kushte minimale:
 - 1.1. Të jene të kyçura në infrastrukturën komunale të ujësjellësit, kanalizimit dhe energjisë elektrike.
 - 1.2. Nëse lokalet afariste gjenden në zona ku nuk është e nderuar infrastruktura komunale e ujësjellësit, kanalizimit, energjisë elektrike, atëherë duhet të posedoj me gjenerator, sigurim alternativ për ujin dhe mbledhjen e ujrave fekal, siç është parapara me dispozita tjera ligjore.
 - 1.3. Të kenë së paku një porte hyrëse e cila duhet të jetë e gjerë të paktën 0.90 m.
 - 1.4. Në rast se lokali afarist ka të ndara derën e hyrjes dhe daljes, në dyer duhet të jenë të vendosura në mënyrë të dukshme shenjat “hyrja” dhe “dalja”.
 - 1.5. Të posedojnë së paku një wc-n me elementet përkatëse sanitare.
 - 1.6. Të kenë ndriçim natyral ose artificial.
 - 1.7. Të kenë ajrosje natyrale apo artificiale.
 - 1.8. Të posedojnë aparat funksional për fikjen e zjarrit.
 - 1.9. Secila shoqëri tregtare, në lokal afarist duhet të posedoj së paku pajisjen e ndihmës së parë (minimumi sikur ajo në vetura/automjete).
 - 1.10. Kontraten valide me kompaninë për menaxhimin e mbeturinave apo dhe së paku fature përmes së cilës dëshmohet se në atë lokal tërhiqen mbeturinat nga kompania e licencuar.
 - 1.11. Lokalet afariste me sipërfaqe prej dhe më shumë se 1000 m² duhet të kenë vende të përshtatshme të parkimit të automjeteve.
 - 1.12. Kontrate/marrëveshje të qeras në mes pronarit të shoqërisë tregtare dhe pronarit të lokalit afarist, nëse pronari i shoqërisë tregtare nuk është dhe pronar i lokalit/objektit.
 - 1.13. Lokali afarist para hyrjes duhet ta ketë sipërfaqen e asfaltuar, betonuar ose e rregulluar me pllaka të gurit ose në ndonjë mënyrë tjetër ashtu që të sigurojë lëvizje të lirë të personave dhe të mundësojë mbajtjen e pastërtisë.
 - 1.14. Në hyrje të lokalit afarist duhet në mënyrë të dukshme të vendoset emri tregtar apo emri i biznesit siç e ka të përshkruar në certifikatën e regjistrimit të biznesit, si dhe shenjat

dalluese për lokalin afarist (numri derës, emri i rrugës, numri filiales/selis nëse biznesi ka me shume se një seli/filiale).

- 1.15. Në hyrje të lokalit afarist duhet të jetë i vendosur orari i punës, siç është përcaktuara me dispozitat përkatëse.
- 1.16. Qasja në lokal afarist duhet të jetë e rregulluar në mënyrë që të mos i pengojë shfrytëzuesit e tjerë të ndërtesës (objektit) në shfrytëzimin e përbashkët të sipërfaqes.
- 1.17. Lokali afarist duhet të ketë lartësinë më së paku 2.0 m.
- 1.18. Lokali afarist i cili është i ndërtuar në dy ose më shumë kate duhet të ketë gjerësinë e shkallëve së paku 1 m.
- 1.19. Dyshemetë e lokaleve afariste duhet të ndërtohen prej materialeve të cilët mundësojnë pastrim të lehtë (pllaka qeramike, të ngjashme dhe jo të rrëshqitshme).
- 1.20. Muret dhe tavanet e lokalit afarist nuk lejohet të jenë të dëmtuara si dhe duhet të jenë të mbrojtura nga lagështia.
- 1.21. Pjesët e lokalit afarist në të cilat shiten mishrat e freskëta e të ngjashme duhet veshur me pllaka qeramike apo materiale të përshtatshme në lartësi jo më pak se 1.50 m nga dyshemeja.
- 1.22. Lokalet afariste me sipërfaqe shfrytëzuese prej dhe më shumë se 100 m², duhet të kenë edhe hapësirën ndihmese.
- 1.23. Lokali afarist duhet të posedoi pajisje të përshtatshme për ngrohje nëse kushtet klimatike e kërkojnë një gjë të tillë, po qese produktet të cilat gjenden në atë hapësirë e përballojnë nxehjen e hapësirës.
- 1.24. Lokali afarist duhet të jetë i pajisur me rafte, tavolinat, vitrinat ftohëse dhe pajisjet tjera të ngjashëm, varësisht nga organizimi i punës dhe lloji i produkteve që shitet apo shërbimeve që kryhen në atë lokal afarist.
- 1.25. Pajisjet e lokalit afarist duhet të jene nga materiali i cili mirëmbahet lehtë, ndërsa përbërja materialit për pajisjet duhet të jete sipas standardeve të pranueshme.

Neni 7

Vetëshërbimi/marketi

1. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregullore, vetëshërbimet duhet të plotësojnë edhe këto kushte:
 - 1.1. Lokali afarist në të cilën shitja e produkteve organizohet në mënyrë të vetëshërbimit të blerësve (vetëshërbyerje), duhet pajisur me mjete adekuate për bartjen e produkteve.
 - 1.2. Në vetëshërbim/market, gjerësia ndërmjet rafteve me produkte të ekspozuara duhet të jetë të paktën 1 m.
 - 1.3. Vendin e veçante ku konsumatori/blerësi mund te kryej pagesën për produktet e blera.
 - 1.4. Raftet, tavolinat shitëse dhe pajisjet e ngjashme duhet të jenë të vendosura në atë mënyrë që hapësira në mes tyre të mundëson lëvizje të lirë.

Neni 8

Qendrat tregtare

1. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregullore, qendra tregtare duhet të plotësojnë edhe këto kushte:
- 1.5. Hapësirën ndihmese, depon, vendin e përshtatshme për parking, mjetet e përshtatshme për bartjen e produkteve, pajisjen për rregullimin e klimës, gjenerator, hapësirat për gardërobe të punëtoreve, wc-të për femra dhe meshkuj të ndara fizikisht.
- 1.1. Lokalet afariste të cilat gjanën në objektin e qendrës tregtare, duhet ti kenë në shfrytëzim hapësirat për gardërobë, hapësirat ndihmese, wc-të për femra dhe meshkuj, jo më larg se 50 m.
- 1.2. Nëse qendra tregtare ka sipërfaqe shitësi me shumë 1000 m² dhe është në më shumë se dy kate, duhet të ketë shkallet lëvizëse apo ashensorin për së paku 4 persona.
- 1.3. Secili lokal afarist i cili gjendet në qendër tregtare duhet në mënyrë të dukshme të vendos emrin tregtar apo emrin e biznesit siç e ka të përshkruar në certifikatën e regjistrimit të biznesit, si dhe shenjat dalluese për lokalin afarist (numri derës, emri i rrugës, numri filiales/selis nëse biznesi ka më shumë se një seli/filiale).
- 1.4. Në objektin në të cilin funksionon qendra tregtare duhet të jetë i ekspozuar emri i biznesit apo emri tregtare i shoqërisë tregtare i cili menaxhon me objektin në tërësi.

Neni 9

Tregjet

1. Për shitjen në tregje kërkohen vetëm këto kushte minimale:
- 1.1. Objekti i tregut duhet të jetë i kyçur në ujësjellësin, kanalizimin dhe rrjetin elektrik.
- 1.2. Hapësira e mjaftueshme për ekspozimin dhe shitjen e produkteve.
- 1.3. Një ose më shumë hapësira të veçanta për magazinimin e produkteve të pajisura me mjete të përshtatshme për transport dhe manipulim me produkte.
- 1.4. Vend për parkim të përshtatshëm për mjetet transportuese.
- 1.5. Hapësira ndihmëse dhe wc-t për meshkuj dhe femra.
- 1.6. Hapësirë të veçantë të destinuar për vendosjen e mbeturinave.
- 1.7. Gjeneratorë për prodhimin e energjisë elektrike nëse në depo/magazina janë të vendosura produkte për cilat është e nevojshme ftohja apo ngrohja.
- 1.8. Lokalin e vecant për punët administrative të pronarit/personit përgjegjës të objektit/tregut.
- 1.9. Objektet e veçanta për magazinimin e prodhimeve ushqimore duhet të pajisen me stabilimente ftohëse dhe ngrohëse përkatësisht për kondicionerin e ajrit me të cilat pajisje sigurohet ruajtja e prodhimeve për periudha më të gjata kohore.
- 1.10. Hapësira shitëse e tregut mund të jetë e mbyllur dhe e hapur.
- 1.11. Lartësia e hapësirës së mbyllur shitëse duhet të jetë së paku 4 m.
- 1.12. Stendat/hapësirat e shitjes në treg duhet ta kenë sipërfaqen shfrytëzuese më së paku 4 m².
- 1.13. Lokalet e vendosura brenda objektit në treg e të cilat sipas dispozitave të kësaj rregullore paraqesin lokal afarist, duhet plotësuar edhe kushtet e përgjithshme të parapara në nenin 6 të kësaj rregullore.

- 1.14. Për hapësirat e mbuluara të tregut sa i përket ndriçimit aplikohen dispozitat e kësaj rregullore.
- 1.15. Për ndërtimin dhe pamjen e dysHEMEVE, mureve dhe shtyllave të pjesës së mbyllur të tregut, aplikohen dispozitat e kësaj rregullore.
- 1.16. Për dyshemetë e pjesës së hapur të tregut, në mënyrë të njëjtë aplikohen dispozitat kësaj rregullore.
- 1.17. Stendat shitëse duhet të jenë të vendosura në atë mënyrë që të krijohet qarkullim i lire dhe i mjaftueshme e të pa penguar të shitësve dhe blerësve.
- 1.18. Pronari i tregut apo personi përgjegjës ka për obligim që ti vendos shenjat orientuese për vendet ku shiten llojet e caktuara të produkteve.
- 1.19. Pronari i tregut apo personi përgjegjës i tregut ka për obligim të prezantoj të inspektori i Tregut apo Sanitar dokumentin përmes së cilës sqarohet ndarja e vendeve për shitësit të cilëve iu është lëshuar vendi i caktuar për shitje.
- 1.20. Me kërkesë të inspektorit të Tregut apo Sanitar, pronari apo personi përgjegjës i tregut, ka për obligim që ti prezantoj të dhënat e bizneseve të cilët shfrytëzojnë hapësirën e tregut.
- 1.21. Në hyrje të objektit të tregut, duhet të jetë i ekspozuar emri i biznesit apo emri tregtare i shoqërisë tregtare i cili menaxhon me objektin/tregun.
- 1.22. Inspektori i Tregut, Sanitar apo i Veterinarisë mund të kërkoj nga pronari apo personi përgjegjës i tregut që të bej ndarjen apo renditjen e produkteve që shiten në treg siç parashihet me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
- 1.23. Tregjet e mbuluar ose të hapura duhet ta kenë të zgjidhur rrjedhën e ujit apo drenazhimi.
- 1.24. Lejen mjedisore komunale, nëse një e tille kërkohet me dispozita tjera ligjore.

Neni 10

Shitja jashtë lokaleve afariste dhe kioskave

1. Për shitjen jashtë lokaleve afariste dhe kioskave kërkohen vetëm këto kushte minimale:
 - 1.1. Shitja jashtë lokaleve afariste apo kioskave mund të behet vetëm në vendet për të cilat Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Gjakovës ka dhënë pëlqim.
 - 1.2. Nëse shitja apo shërbimi i produkteve behet përmes makinave/automateve është e vendosur në pronë private atëherë duhet kontrata/marrëveshja në mes pronarit dhe shfrytëzuesit të hapësirës.
 - 1.3. Në automat duhet të vendoset të dhënat e pronarit të automatit pa marre parasysh a gjendet në sipërfaqe publike apo brenda lokalit afarist dhe ku do tjetër.
 - 1.4. Nëse shitja apo shërbimi i produkteve behet në panaireve, atëherë personat përgjegjës kanë për obligim që të pajisen me pëlqim të përkohshëm nga organi kompetent nëse si të tilla mbahen në sipërfaqe publike.
 - 1.5. Nëse panaireset mbahen në objekte të mbyllura duhet pajisen me pëlqim, sipas kësaj rregullore. Kushtet minimale që duhet ti kenë këto objekte të mbyllura janë: rryma, uji, wc-të, dhe sipas vlerësimit të inspektorit me kushtet minimale të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregullore.

2. Kushtet higjienikë, sanitare dhe të tjera, në rastet e shitjeve jashtë lokaleve afariste dhe kioskave i mbikëqyrin inspektoratet kompetente, varësisht prej kompetencave që kanë.

Neni 11

Shitja ne kioska

1. Kioskat në të cilën kryhen shitjet apo ofrimi i shërbimeve kërkohen vetëm këto kushte minimale:
 - 1.1. Brendësia e kioskës në brendësi nuk mund të jetë më e vogël se 4 m², me kusht që në hapësirën e kioskës të sigurohet ajrosja natyrale ose artificiale.
 - 1.2. Duhet të sigurohet nxehje dhe asaj freskuese në kioskë.
 - 1.3. Kioska në të cilën shiten produktet ushqimore duhet të jetë i pajisur me lavaman dhe me ujë.
 - 1.4. Kioska duhet të ketë në shfrytëzim wc-në në largësi jo më të largët se 50 m.
 - 1.5. Kontratën/marrëveshjen valide në mes qiradhënësit dhe qiramarrësit.
 - 1.6. Dëshmi kontrate/marrëveshje me kompaninë e licencuar për menaxhimin e mbeturinave.
 - 1.7. Të jete të e kyçur në infrastrukturën komunale të ujësjellësit, kanalizimit dhe energjisë elektrike. Përgjithshme të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregullore, lokali afarist në të cilin behet tregtia e automjeteve duhet të posedoj edhe me hapësirën për parkingun e automjeteve. Nëse automjetet ekspozohen në sipërfaqe publike, atëherë duhet të posedoj pëlqim/kontrate me/nga organi kompetent i komunës.
 - 1.8. Nëse kioska gjenden në zona ku nuk është e nderuar infrastruktura komunale e ujësjellësit, kanalizimit, energjisë elektrike, atëherë duhet të posedoj me gjenerator, sigurim alternativ për ujin dhe mbledhjen e ujerave fekale, siç është parapara me dispozita tjera ligjore.

Neni 12

Lokalet afariste në të cilat ushtrohet veprimtaria ekonomike e tregtisë me shumicë, pakicë, riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave (sektori G)

1. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregullore, lokali afarist në të cilin behet tregtia e automjeteve duhet të posedoj edhe me hapësirën për parkingun e automjeteve. Nëse automjetet ekspozohen në sipërfaqe publike, atëherë duhet të posedoj pëlqim/kontrate me/nga organi kompetent i komunës.
2. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregullore lokali afarist në të cilin behet mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, duhet të posedoj edhe me lejen mjedisore komunale, nese një e tille kërkohet me dispozita tjera ligjore.
3. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregullore, lokali afarist në të cilin bëhet lustrimi (larja) e automjeteve (autolarjet), duhet siguruar që uji të mos depërtoj në sipërfaqe publike dhe në hapësirat apo objektet tjera për rreth si dhe duhet të posedoj me lejen mjedisore komunale, nëse një e tille kërkohet me dispozita tjera ligjore.
4. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregullore, lokali afarist në të cilat ushtrohet tregtia me pakice e artikujve farmaceutikë (Barnatore), duhet të kenë edhe

hapësirë totale minimum 42 m², hapësirën për dhënien e barnave minimum 24 m² me dysHEME të ndërtuar nga materiali i forte, i lëmuar që mundëson pastrimin e lehtë dhe dezinfektimin, hapësirën ndihmese të ndare fizikisht, frigoriferin ftohës i cili posedon pajisje për regjistrimin e temperaturës, pajisjen që regjistron temperaturën brenda lokalit afarist, shenjen mbrojtëse të dukshme të veprimtarisë farmaceutikë që është plusi i gjelbër.

5. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregullore, lokalet afariste në të cilat ushtrohet veprimtaria ekonomike e tregtisë me pakicë apo shumice e karburantit për automjete (pompat e benzinës dhe të shitjes së gazit/propan, butan), duhet të posedoj edhe me: hapësirë shitëse për shitjen e lubrifikanteve dhe vajrave me së paku 8 m², hapësirat para objektit/lokalit duhet të jene nga materiali i forte (kubëza, betoni e ngjashëm), të sigurohet hapësirë e mjaftueshme dhe pa pengese për ngarkimin dhe shkarkimin e derivateve, të siguroje hapësirë të veçante për gardërobën e punëtorëve, mbishkrimet e qarta dhe të dukshme për rrezikun nga zjarri, hapësirën e veçantë për mjetet higjienike e sanitare, certifikatën/fletën poseduese të parcelës me dëshminë e lejes së ndërtimit të lokalit, lejen mjedisore komunale, nëse një e tille kërkohet me dispozita tjera ligjore.

Neni 13

Veprimtaritë ekonomike të shërbimit me duhan (shisha baret)

Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregullore, lokali afarist në të cilin behet shërbimi me produkte të duhanit (të modifikuara apo të pamodifikuara gjenetikisht e që përdoren për tu pirë përmes shisheve/llullave të ndryshme), duhet të jene së paku pesëdhjetë (50) metra në largësi të drejtpërdrejt të objekteve edukative-arsimore, të institucioneve historike, objekteve komunale, shtëpive/banesave të banimit.

Neni 14

Veprimtaritë ekonomike të akomodimit (Sektori I)

1. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregullore, lokali afarist në të cilin ushtrohet veprimtaria ekonomike e hoteleve apo moteleve, duhet ti plotësoj edhe këto kushte: të ketë siguruar përherë ujë të nxehtë dhe të ftohtë, të posedoj gjeneratorë për kapacitetet e tere lokalit/objekti, hapësira e guzhinës nuk mund të jete më e vogël se 4 m², të posedoj me së paku një dhomë të veçante për personelin/punëtorët, të paktën një hapësirë ndihmese, secila dhomë në hotele dhe motele duhet të posedojnë me banjë ku përfshihet lavamanët e duarve, wc-të, tush kabinë, ujë të ngrohtë dhe të ftohtë, furnizimi i duhur me ujë të pijshëm në secilën dhomë, ndriçim dhe ventilim natyral apo artificial për secilën dhomë.
2. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregullore, lokalet/objektet në të cilat ushtrohet veprimtaria ekonomike e pushimeve dhe akomodimet e tjera me qëndrim të shkurtër (villa, shtëpitë për fëmijët dhe shtëpitë e festave tjera, banesat dhe bungallet e vizitorëve), duhet ti plotësojnë edhe këto kushte: të paktën një hapësirë ndihmese, secila dhomë

në hotele dhe motele duhet të posedojnë me banjë ku përfshihet lavamanët e duarve, wc-të, tush kabinë, ujë të ngrohtë dhe të ftohtë, furnizimi i duhur me ujë të pijshëm në secilën dhomë, ndriçim dhe ventilim natyral apo artificial për secilën dhomë.

Neni 15

Aktivitetet Shërbyese të Ushqimit dhe Pijeve (Sektori I)

Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregullore, lokalet apo objektet në të cilat ushtrohet veprimtaria ekonomike e restoranteve apo veprimtarive shërbyese të ushqimit apo pijeve (restorant, kafene, bareve, diskoteka dhe ngjashëm), duhet të plotësoj edhe këto kushte: pajisjet adekuate për ruajtjen e produkteve ushqimore, tavolinat dhe karriget.

Neni 16

Veprimtaritë ekonomike të arsimit (sektori P)

Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregullore, lokalet apo objektet në të cilat ushtrohet veprimtaria ekonomike e arsimit, duhet të plotësoj edhe këto kushte: vërtetimin e dezinfektimit, dertatizimit dhe dezinfektimit, hapësirë e ndarë për ruajtjen e mjeteve higjienike.

Neni 17

Veprimtaritë e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale (sektori Q)

1. Përveç kushteve të përgjithshme të parapara me këtë rregullore, këto lokalet duhet të plotësojnë edhe këto kushte:
 - 1.1. Të sigurohet qasje e lehtë në lokal për personat me nevojë të veçantë.
 - 1.2. Aty ku ofrohen shërbimet e urgjencës, të sigurohet qasja e lehtë dhe vend parkimi për autoambulance.
 - 1.3. Të këtë të sigurohet ngrohjen dhe ftohjen për lokalin afarist.
 - 1.4. Të posedoj me wc-të për personelin dhe pacientet si dhe hapësirë ndihmese.
 - 1.5. Dyshemeja, dyert, dritaret, krevatet, tavolinat dhe mjetet tjera të punës duhet të jetë nga materiali i cili mundëson pastrimin, dezinfektimin e lehtë dhe të shpejtë.
 - 1.6. Të sigurohen shportat e veçanta për hedhjen e mbeturinave për vendosjen e mbeturinave medicinale dhe mbeturinave të tjera.
 - 1.7. Në çdo moment duhet të posedoj me ujë të pijshëm, në rast të ndërprerjes nga rrjeti i ujësjellësit.
 - 1.8. Të posedoj me gjenerator i cili duhet të funksionoj (ndezët) në mënyrë automatike (vlen për ato veprimtari të cilat në përbërjen e tyre kanë bllokun operativ, kujdesin intensiv).
 - 1.9. Brenda lokalit afarist duhet të jenë të shkruara qarte dhe të ekspozuara në vend të dukshëm llojet e shërbimeve që ofrohen.

Neni 18

Veprimtaritë e arteve, argëtimit dhe rekreacionit (sektori R)

1. Lokalet afariste në të cilat ushtrohet veprimtaria ekonomike e argëtimit dhe rekreacionit,

minimumi i kushteve qe duhet plotësuar janë ato të përshkruara ne nenin 6.

2. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregullore, lokalet apo objektet në të cilat ushtrohet veprimtaria ekonomike e pishinave (të hapura dhe të mbyllura) duhet të plotësojnë edhe këto kushte: zyrën/lokalin e administratës, të kenë të vendosur në hyrje të pishinës rregullat që duhet zbatuar, dhomën e veçantë për ndihme të parë, shtratin, se paku një person adekuat (shpëtimtarin), dhomat/kabinat e ndërrimit dhe wc-të (veçantë për gratë dhe burrat), tushin për larje, dhomën e veçantë për mjetet higjienike, dezinfektuese dhe ngjashëm, vërtetimin e dezinfektimit, dertatizimit dhe dezinfektimit.

Neni 19

Veprimtaritë ekonomike të parkimit (auto parkingu)

1. Për lokalet afariste, hapësirat në të cilat ushtrohet veprimtaria ekonomike e parkimit të automjeteve, kërkohen vetëm këto kushte minimale:
 - 1.1. Tregtari që ofron hapësirë për parkimin e automjeteve apo hapësira parkimi me qira në garazhe duhet të vendos çmim orën në hyrje, ku personi që drejton një automjet në drejtim të parkingut të ketë pamje të lehte dhe qartë në çmimet e parkimit.
 - 1.2. Çmimorja e cila duhet të përcaktojë çmimin për ore dhe dite dhe të mos ketë paqartësi.
 - 1.3. Të posedoj minimum një kioske, me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë rregullore.
 - 1.4. Nëse hapësira e parkingut posedon lokal afarist, atëherë duhet plotësuar kushtet dhe kriteret për lokale, siç janë përcaktuar me këtë rregullore.
 - 1.5. Kontrate/marrëveshje të qirasë në mes pronarit të shoqërisë tregtare dhe pronarit të lokalit afarist/sipërfaqes nëse pronari i shoqërisë tregtare nuk është dhe pronar i lokalit/objektit/sipërfaqes.
 - 1.6. Sipërfaqja e parkingut duhet të jete e asfaltuar, betonuar ose e rregulluar me pllaka të gurit ose në ndonjë mënyrë tjetër ashtu që të sigurojë lëvizje të lirë të personave dhe veturave dhe të mundësojë mbajtjen e pastërtisë.
 - 1.7. Në hyrje të hapësirës së parkingut duhet në mënyrë të dukshme të vendoset emri tregtar apo emri i biznesit siç e ka të përshkruar në certifikatën e regjistrimit të biznesit, si dhe shenjat dalluese për lokalin afarist (numri derës, emri i rrugës, numri filiales/selis nëse biznesi ka me shume se një seli/filiale).
 - 1.8. Në hyrje të hapësirës së parkingut duhet të jete i vendosur orari i punës, siç është përcaktuara me rregulloren komunale.

Neni 20

Veprimtaritë tjera ekonomike

Lokalet afariste tjera në të cilat ushtrohet ndonjë veprimtari ekonomike e caktuar dhe e cila nuk është parapare me këtë rregullore, apo me ndonjë dispozite të veçante në këtë rregullore, atëherë

minimumi i kushteve që duhet plotësuar janë kushtet e përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregullore, varësisht se në cilin sektor bën pjesë.

Neni 21

Inspektimi

1. Inspektori i Tregut, Sanitar apo Inspektori i Mbrojtjes së Mjedisit, kryen inspektim sipas detyrës zyrtare, në bazë të kërkesës së palës, ankesës apo kërkesës së palës së treta. Inspektori i Tregut, Sanitar apo Inspektori i Mbrojtjes së Mjedisit është i detyruar që të informojë parashtruesin e ankesës lidhur me gjendjen e konstatuar, respektivisht masat e ndërmarra brenda tetë (8) ditësh.
2. Inspektori i Tregut apo Sanitar në çdo kohë mund të ndaloj përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë dhe mbyll lokalin afarist në të cilin ushtrohet veprimtaria ekonomike pa pëlqim dhe në rastet kur personi fizik apo juridik nuk vepron sipas urdhërësës së dhënë bazuar në dispozitat e kësaj rregullore. Mbyllja mund të bëhet me procesverbal dhe mund ti vendosen bllokat/shenjet zyrtare mbyllur.
3. Inspektori i Tregut apo Sanitar është i obliguar që brenda 48 orësh pasi ka mbyllur lokalin/objektin të nxjerr vendim për ndalim të përkohshëm të veprimtarisë. Inspektori sipas vlerësimit mund të mbyll tere lokalin/objektin edhe nëse shoqëria tregtare posedon pëlqim për ndonjë veprimtari tjetër ekonomike. Mbyllja bëhet sipas paragrafit 2 të këtij neni.
4. Inspektori i Tregut, Sanitar apo Inspektori i Mbrojtjes së Mjedisit mund të lëshoj urdhërësë me shkrim për parregullsitë e konstatuara. Në urdhërese e cakton afatin për eliminim të parregullsive i cili nuk mund të jete me i gjatë se 30 dite.
5. Inspektori i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Inspektori i Tregut mund të ndaloj ushtrimin e veprimtarisë ekonomike nëse pronari i shoqërisë tregtare në vazhdimësi prish rendin dhe qetësin publike nga përdorimi i zhurmës apo pushimin dhe qetësinë e natës, si dhe të ndaloj përdorimin e makinave, mjeteve transportuese, pajisjeve dhe aparateve deri sa nuk ndermirën masa për mbrojtje nga zhurma apo deri në një vendim të organit kompetent në të cilin përcaktohen masat mbi mbrojtjen nga zhurma.
6. Inspektori i Mbrojtjes së Mjedisit mund të urdhëroj personat juridik apo fizik të cilët e përdorin burimin e zhurmës në mjedise ku njerëzit banojnë ose jetojnë, që të bëjnë matjen e nivelit të zhurmës. Shpenzimet e krijuara i barte pronari i shoqërisë tregtare.

Neni 22

Kërkesa për pajisje me pëlqim

1. Për pajisje me pëlqim, pronari apo personi përgjegjës i shoqërisë tregtare duhet të paraqes

kërkesën zyrtare në arkivin e komunës.

2. Kërkesa i dërgohet për trajtim komisionit, jo me vone se 48 ore.

Neni 23

Komisioni për pranim teknik

1. Komisioni është i obliguar që brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës të kryej inspektim, sipas kërkesës së palës.
2. Komisioni mund të ftoj edhe Inspektor të tjerë me qëllim të inspektimit dhe rekomandimeve të nevojshme.
3. Komisioni ka për obligim të hartoj procesverbal në momentin e inspektimit në të cilin përshkruhet gjendja faktike, numri i lëndës së kërkesës së palës, emri dhe mbiemri i pronarit të lokalit (sipas deklarimeve të palës prezentë), pronarit të shoqërisë tregtare, katet e lokalit (specifikohet secili kate sa sipërfaqe posedon dhe shfrytëzon për veprimtarinë ekonomike), urdhëresën për eliminim të parregullsive nëse eventualisht ka ndonjë parregullsi që duhet eliminuar, këshillën juridike, kodet e veprimtarisë për të cilat lokali i plotëson kushtet minimale sipas kësaj rregullore dhe vërejtjet apo dhe sqarime shtese sipas nevojës.
4. Inspektori i Tregut, Sanitar, Inspektori i Mbrojtjes së Mjedisit apo komisioni për pranim teknik, sipas vlerësimit të tyre, mbi baze të ankesave të banoreve, të Policisë së Kosovës, mund të kërkojë pronarit të shoqërisë tregtare vërtetim/dokument zyrtar nga organet kompetente se a janë duke u zbatuar masat e mbrojtjes nga zhurma. Shpenzimet e krijuara i barte pronari i shoqërisë tregtare.

Neni 24

Procedura e lëshimit të pëlqimit

1. Njeri nga anëtarët e komisionit i caktuar si kryesues i komisionit nga udhëheqësi i drejtpërdrejt është i obliguar që brenda 30 ditëve kalendarik, pas konstatimit të gjendjes me procesverbal të lëshon pëlqim përmes së cilit i lejohet ushtrimi i veprimtarisë apo veprimtarive ekonomike të caktuara. Lëshimi i pëlqimit sipas kësaj rregullore nuk nënkupton se lokali afarist i plotëson edhe kushtet/kriteret e tjera të cilat mund të kërkohen me akte tjera ligjore apo nen ligjore.
2. Në pëlqim të lëshuar duhet të ceket me patjetër numri i kërkesës së palës, emri dhe mbiemri i pronarit të shoqërisë tregtare, data dhe numri i procesverbalit përmes së cilit është konstatuar gjendja faktike, numri personal, kodi/kodet e veprimtarisë për të cilën/cilat është lëshuar pëlqimi me sqarime shtese për llojin e veprimtarisë për të cilin i është lëshuar, numri unik identifikues, emri tregtar (nëse ka të tillë), lokacioni i saktë (rruga, numri derës së lokalit), afati i vlefshmërisë së pëlqimit, vërejtje apo sqarime shtese sipas nevojës me qëllim të identifikimit

sa me të lehte të lokalit dhe sqarimit tjetër të nevojshëm.

3. Pëlqimi mund të lëshohet për me shume se një veprimtari ekonomike (kode), me kusht që të jene plotësuar kushtet minimale të përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 25

Pëlqimi për veprimtari ekonomike të veçanta

1. Pëlqimi për hotele dhe motele lëshohet për tere objektin në të cilin gjenden dhomat dhe lokalet tjera përcjellëse të cilat janë brenda objektit. Në pëlqim duhet të ceket numri i dhomave funksionale.
2. Për vila, shtëpitë e festave tjera, bungallët e vizitorëve, bujtina, dhe akomodimet e tjera me qëndrim të shkurtër, pëlqimi kërkohet për secilin objekt/lokal veç e veç. Në pëlqim duhet të ceket numri i objekteve/vilave.
3. Pëlqimi për tregje lëshohet dhe vlejnë për të gjitha shoqëritë tregtare të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike brenda atij tregu, objekti. Nëse brenda tregut gjenden lokal afarist i ndare fizikisht, atëherë, përveç pëlqimit për treg, duhet të kenë edhe pëlqimin e veçantë për atë lokal afarist.
4. Shoqëritë tregtare të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në qendra tregtare kane për obligim të pajisen me pëlqim për të gjitha lokalet afariste të cilat janë të ndara fizikisht nga njëra tjetra (me mure, xhama apo çfarë do materiali tjetër që shërben për ndarje të lokalit).

Neni 26

Procedura e refuzimit të kërkesës

1. Njeri nga anëtarët e komisionit i caktuar si kryesues i komisionit nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë është i obliguar që brenda 30 ditëve kalendarik, pas konstatimit të gjendjes me procesverbal të nxjerr vendim përmes së cilit e refuzon kërkesën e palës nëse lokali nuk plotëson kushtet e parapara me këtë rregullore, kur një veprimtari ekonomike e caktuar është e ndaluar me dispozita apo akte tjera ligjore në fuqi apo edhe nëse brenda afatit të përcaktuar nga inspektori nuk i ka plotësuar kushtet, sipas kësaj rregullore.
2. Inspektori i Tregut apo Sanitar apo komisioni për pranim teknik nuk ka të drejt të lëshoj pëlqim për veprimtari ekonomike të cilat janë të ndaluara me ndonjë ligj të veçantë. Nëse një veprimtari ekonomike është ndaluar me ligj të veçantë pasi është pajisur me pëlqim, komisioni për pranim teknik ka për obligim që ta shfuqizoj pëlqimin.
3. Në vendimin për refuzim të kërkesës apo shfuqizim të pëlqimit duhet të ceket me patjetër arsyet për refuzim apo shfuqizim, të drejtën e ankesës si dhe struktura dhe elementet tjera të cilat

duhet ti përmbaj akti administrativ, të përcaktuara me ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

4. Komisioni për pranim teknik mund ta refuzoj kërkesën apo shfuqizoj pëlqimin nëse një veprimtari ekonomike ushtrohet duke mos respektuar dispozitat mbi zhurmat apo kur nuk dëshmon vërtetim nga organi kompetent mbi nivelin e zhurmës, dhe në rastet e tjera të përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 27

Procedura e ankesës kundër vendimit të inspektorit

1. Kundër vendimit të inspektorit apo kryesuesit të komisionit lejohet ankesë brenda afatit prej tete (8) ditëve kalendarike, e cila i drejtohet komisionit për shqyrtimin e ankesave në Komunën e Gjakovës.
2. Parashtrimi i ankesës kundër vendimit të inspektorit nuk e ndalon ekzekutimin e tij.
3. Komisioni për shqyrtim të ankesave i përberë prej tre anëtarësh i propozuar nga Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Gjakovës dhe i miratuar nga udhëheqësi me i larte administrativ i Komunës së Gjakovës, është i detyruar që në afat prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga dita e paraqitjes së ankesës të vendos për ankesën e ushtruar.
4. Kundër vendimit të komisionit për shqyrtim të ankesave mund të parashtrohet padi në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Neni 28

Fillimi i procedurës ndëshkuese

1. Në rastet kur konstatohet se janë shkelur dispozitat e kësaj rregullore, inspektori i Tregut apo Sanitar mundet që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh kalendarike nga dita e konstatimit të shqipton gjobë.
2. Nëse subjekti i gjobitur e bën pagimin e gjobës, brenda afatit ligjor të përcaktuar nga Inspektori, lirohet nga pagesa prej 50% nga shuma e gjobës së shqiptuar.
3. Në rast se subjekti i gjobitur nuk e paguan gjobën brenda afatit të dhënë nga inspektori i Tregut apo Sanitar ka të drejtë të filloj edhe procedura tjera administrative për inkasimin e gjobës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Inspektori i Tregut apo Sanitar kur konstaton se janë shkelur dispozitat e kësaj rregullore, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh kalendarike mund të paraqet kërkesë për fillim të procedurës për kundërvajtje në gjykatën kompetente, kur kjo është e paraparë me ligje të veçanta.

Neni 29

Dispozitat ndëshkuese

1. Personi fizik apo personi përgjegjës i personit juridik gjobitet me gjobë nga njëzet (20) euro, dhe jo me shumë se njëmijë (1.000) euro, nëse shkel dispozitat e kësaj rregullore apo kur nuk vepron sipas urdhëresës së inspektorit.
2. Personin fizik që ushtron biznes individual gjobitet me gjobë nga pesëdhjetë (50) euro, dhe jo me shumë se njëmijë e pesëqind (1.500) euro, nëse shkel dispozitat e kësaj rregullore apo kur nuk vepron sipas urdhëresës së inspektorit.
3. Personi juridik gjobitet me gjobë nga njëqind (100) euro, dhe jo me shumë se dymijë (2.000) euro, nëse shkel dispozitat e kësaj rregullore apo kur nuk vepron sipas urdhëresës së inspektorit.
4. Gjoha për mos pajisje me pëlqim nuk mund të jete me e ulet se sa pagesa për pajisje me pëlqim.

Neni 30

Pagesa për pajisje me pëlqim

1. Pagesa për pajisje me pëlqim për Bizneset Individuale (B.I.), është 50 euro (pesëdhjetë euro).
2. Pagesa për pajisje me pëlqim për shoqëritë tjera tregtare që nuk janë biznese individuale (B.I.), është 100 euro (njëqind euro).
3. Pagesa për shtim të kodit nëse paraprakisht i është lëshuar një pëlqim është 10 euro (dhjetë euro), për një kode të veprimtarisë. Kodi i shtuar është i vlefshëm për aq kohe sa është pëlqimi i cili plotësohet/ndryshohet me shtruarjen e kodit. Procedura e plotësim ndryshimit është e parapare me Ligj për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
4. Përfshirje nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij nenin, bëjnë shoqëritë tregtare të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në kioska, pagesa për të cilat është 20 euro (njëzet euro).

Neni 31

Vlefshmeria e pëlqimit

Pëlqimi i lëshuar nga kryesuesi i komisionit është i vlefshëm për 3 vite (tri vite), nga dita e lëshimit, me kusht që gjatë kësaj periudhe nuk janë bere ndryshime në lokalin afarist për të cilin është lëshuar dhe nëse veprimtaria e tillë nuk është ndaluar me ndonjë ligj të veçantë. Pas kalimit të afatit prej 3 viteve (tri viteve), pronari i shoqërisë tregtare duhet të ri-përsëris kërkesën për pajisje me pëlqim. Procedurat e tjera janë të njëjta.

Neni 32

Mbikëqyrja e zbatimit të kësaj rregullore

1. Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregullore e bën Drejtoria për Punë Inspektuese përmes inspektorëve kompetent.
2. Inspektori i Mbrojtjes së Mjedisit, Policia e Kosovës dhe zyrtarët e tjerë publik kompetent do të mbikëqyrin dispozitat tjera ligjore në fuqi e që janë në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me ligje dhe akte tjera nen ligjore.
3. Me propozim të Udhëheqësit me të lart Administrativ të Komunës apo drejtorëve të drejtorive të Komunës së Gjakovës, Asambleja/Kuvendi i Komunës së Gjakovës mund të vendos që për veprimtari ekonomike të caktuara të caktohen lokacione të veçanta brenda territorit të Komunës së Gjakovës. Komisioni për pranim teknik ka për obligim të veproj sipas vendimeve të Asamblesë/Kuvendit të Komunës së Gjakovës.

Neni 33

Shtojca e kësaj rregullore

1. Për nevoja të sqarimit të veprimtarive ekonomike të paraparë me këtë rregullore duhet ti referohet Vendimit të Qeverisë me Nr.04/123 i datës 05.04.2013 (Klasifikimi i Veprimtarive Ekonomike Nac Rev.2).
2. Kërkesa zyrtare për pajisje me pëlqim.

Neni 34

Mbledhja e mjeteve

Mjetet e mbledhura nga zbatimi i kësaj rregullore derdhen në Buxhetin e Komunës së Gjakovës.

Neni 35

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Të gjithë pronaret e shoqërive tregtare të cilët janë të pajisur me aktvendim mbi plotësim të kushteve minimale me rregulloren e shfuqizuar, obligohen që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh të paraqesin kërkesë për pajisje me pëlqim sipas kësaj rregullore.

Neni 36

Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet Rregullorja Nr.011/3370/2009 e datës 29.05.2020 Mbi plotësimin e kushteve minimale higjieno-teknike sanitare, mbrojtjes në punë dhe mbrojtjes së mjedisit për nga aspekti i hapësirave punuese dhe stabilimenteve dhe pajisjeve dhe aktvendimet e lëshuara në baze të kësaj rregullore dhe neni 11 (paragrafi 11.1.) i Rregullores Nr.011-43964 e datës 06.07.2015 Për taksa, tarifa dhe ngarkesa nga shërbimet komunale.

Neni 37
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb faqen e komunës së Gjakovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gjakovës

Anton Shala

DRAFT